



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Prot 242

Tiranë, 24 mars 2022

Vendim nr. 14, datë 24 mars 2022  
Për miratim botimesh jubilarë

Në përputhje me nenin 7 (veprat me karakter përrurues-jubilar) të Rregullores për veprimtarinë botuese në Akademinë e Shkencave; veprat e listuara më poshtë, miratuar për botim nga Kryesia me vendimin nr.6, datë 17.01.2022; si dhe pasqyrës së veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave për vitin 2022 (bashkëngjitur), duke qenë të gatshme për botim dhe në përputhje me kalendarin vjetor të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave, të botohen me përparësi, duke respektuar procedurat përkatëse:

1. Artan Boriçi, *Scientific research contributions in physics, applied mathematics and computer science*, në dy vëllime. Botimi të jetë gati deri më 15 prill 2022 dhe të përfshihet në kalendarin e promovimeve të panairit të librit akademik dhe shkencor. Për dorëzimin përfundimtar ngarkohet akad. asoc. Mimoza Hafizi.
2. *Festschrift kushtuar akad. Titos Jochalas*, anëtar nderi i Akademisë së Shkencave (përmbledhje studimesh në nderim të veprimtarisë së tij shkencore). Botimi të jetë gati deri më datën 10 maj dhe të përrurohet në ditën e përrurimit të Njesisë AAA, në veprimtarinë shkencore të parashikuar për 80-vjetorin e lindjes së autorit. Për përgatitjen për botim ngarkohet akad. Shaban Sinani. Përmbajtja e librit *Festschrift* sipas pasqyrës bashkëngjitur.
3. Luan Starova, *shkrimtari i shumëgjuhësisë*, akte të konferencës shkencore kushtuar veprës së tij (kërkuar për botim maqedonisht në revistën shkencore *MANUScript* të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut), të kalojë nga lista e miratuar e botimeve

digjitale në atë të botimeve jubilarë. Përgatitja për botim të bëhet nga akad. Shaban Sinani e dr. Arian Leka. Pasqyra e lëndës bashkëngjitur.

4. Të kalojnë prej listës së botimeve përruese-jubilarë në listën e botimeve shkencore tre vëllimet e para të akteve të konferencës shkencore ndërkombëtare të studimeve albanologjike (lista bashkëngjitur). Renditja e autorëve, shenjimi hyrës dhe përgatitjet e tjera për botim të realizohen nga akad. Pëllumb Xhufi e akad. Shaban Sinani, anëtarë të komitetit shkencor të konferencës (pasqyra bashkëngjitur). Aktet e konferencës të përmbajnë: përbërjen e komitetit organizues, përbërjen e komitetit shkencor dhe të komitetit të nderit. Botimi të vijojë me vëllime të tjera vitin e ardhshëm. Të gjitha vëllimet të mbajnë shenjimin: *Nën kujdesin e kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi*. Në vëllimin e parë të përfshihet si shtojcë një përzgjedhje e vlerësimeve të albanologëve të huaj për këtë kuvend.

5. Të përfshihet në këtë listë vëllimi me shkrime kushtuar Qemal Stafës në 80-vjetorin e rënies, përgatitur nga Instituti i Historisë Ushtarake dhe Shoqata të Rënëve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

